



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Rregulla për Shqyrtimin e të Hyrave të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

Prishtinë, Janar 2017



Përmbajtja:

RREGULL PËR PËRCAKTIMIN E TË HYRAVE TË FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT	2
KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	2
Neni 1 Qëllimi	2
Neni 2 Parimet e përgjithshme	2
Neni 3 Përkufizimet dhe interpretimi	3
KREU II KOMPONENTET E KOSTOVE	5
Neni 4 Përbërja e kostove	5
Neni 5 Kostot direkte të furnizimit me pakicë	5
Neni 6 Kostot që ndërlidhen me vëllimin e energjisë së furnizuar	5
Neni 7 Kostot e bartshme	6
KREU III PARAMETRAT HYRËS PËR LLOGARITJEN E KOSTOVE	7
Neni 8 Parametrat hyrës	7
Neni 9 Kostot e lejuara të borxhit të keq	7
KREU IV LLOGARITJA E TË HYRAVE	8
Neni 10 Llogaritja e Të Hyrave të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	8
KREU V PËRSHTATJA E TË HYRAVE	9
Neni 11 Përshtatjet vjetore	9
KREU VI PARIMET E STRUKTURËS SË ÇMIMEVE	10
Neni 12 Mbulimi i kostove të Furnizimit të Mundësisë së Fundit	10
Neni 13 Procesi i azhurnimeve vjetore	10
KREU VII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE	11
Neni 14 Gjuha Zyrtare	11
Neni 15 Ndryshimi	11
Neni 16 Interpretimi	11



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji sipas autoritetit të dhënë me nenin 9, paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, nenin 47 paragrafi 3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr 05/L-084), dhe nenit 39 paragrafi 9 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr 05/L-085), në seancën e mbajtur me datë [date] [muaji] 2017, miratoi këtë:

RREGULL PËR PËRCAKTIMIN E TË HYRAVE TË FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

- 1 Kjo Rregull përcakton parimet dhe metodologjinë e përcaktimit të të hyrave për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit (tani e tutje: FMF) i cili furnizon me energji elektrike konsumatorët e kualifikuar për furnizim nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (furnizim i garantuar) në Kosovë.
- 2 Kjo Rregull mbron konsumatorët fundorë në tregun e energjisë duke ju siguruar dispozita për vazhdimësinë e furnizimit me energji elektrike për një periudhë të kufizuar kohore në rastin kur furnizuesi relevant dështon të vazhdojë të ofrojë shërbimin e furnizimit me energji elektrike.

Neni 2 Parimet e përgjithshme

- 1 Kostot e lejuara të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit përcaktohen nga Rregullatori në baza vjetore.
- 2 Kostot direkte të ofrimit të shërbimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit mbulohen nga tarifat e aplikuar në Transmetim si Obligim i Shërbimit Publik.
- 3 Kostot që lidhen me vëllimin e shërbimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit mbulohen nga tarifat e aplikuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit ndaj Konsumatorëve të Kualifikuar për Furnizim.
- 4 Përshtatjet vjetore do të reflektojnë ndryshimet në mes të të hyrave aktuale dhe kostove aktuale të blerjes së energjisë për furnizimin e Konsumatorëve të Kualifikuar për Furnizim.



Neni 3 **Përkufizimet dhe interpretimi**

- 1 Shprehjet e përdorura në këtë rregull kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Furnizues** - ndërmarrje e energjisë e licencuar nga Rregullatori për të kryer veprimtarinë e furnizimit;
 - 1.2. **Furnizim** - shitje, përfshirë rishitjen e energjisë elektrike te konsumatorët;
 - 1.3. **Furnizim i garantuar** - furnizim i përkohshëm i konsumatorit fundor, të cilit, në raste të përcaktuara me Ligjin për Energjinë Elektrike dhe me këtë rregull, i mundësohet furnizimi i përkohshëm me kufizimet e përcaktuara me ligjet në fuqi;
 - 1.4. **Furnizues i mundësisë së fundit (FMF)** - është një furnizues i përcaktuar nga Rregullatori i cili ofron shërbimin e furnizimit në kushte të rregulluara ndaj konsumatorëve për një periudhë të kufizuar kohore, të cilët nuk kanë mundur të kontraktjnë vetë një furnizues ose kanë humbur furnizuesin e tyre;
 - 1.5. **Konsumator i Kualifikuar për Furnizim të Garantuar** – është konsumatori fundor i cili nuk ka marrëveshje për furnizim me ndonjë nga Furnizuesit e licencuar në Kosovë;
 - 1.6. **ARR Të hyrat aktuale të faturuara nga FMF** - Të hyrat e faturuara nga FMF për ofrimin e Shërbimit të Garantuar;
 - 1.7. **AR Të hyrat e parashikuara të FMF-së** - Të hyrat që mund të mbulohen brenda një viti relevant;
 - 1.8. **Përshtatje vjetore** - përshtatjet e të hyrave të lejuara dhe të realizuara në fund të çdo viti relevant;
 - 1.9. **Borxhi i keq i lejuar** - e ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 7,
 - 1.10. **Ditë pune** - të gjitha ditët e punës brenda një jave, të përcaktuara sipas ligjeve në Kosovë;
 - 1.11. **Operatori i Sistemit të Shpërndarjes** - personi fizik ose juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, sipas nevojës, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar, si dhe ku është e mundur interkonektorët e tij me sistemet tjera, si dhe për sigurimin e aftësisë afatgjate të sistemit për të mbuluar kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë elektrike;
 - 1.12. **Operator i sistemit të transmetimit** - personi fizik, ose juridik përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, sipas nevojës, zhvillimin e rrjetit të transmetimit në një zonë të caktuar përfshirë kurdo që kjo është e mundur, interkonektorët me sistemet tjera, dhe për të garantuar aftësinë afatgjate të rrjetit për të përmbushur kërkesat për transmetimin e energjisë elektrike;
 - 1.13. **Operator i Tregut (OT)** - ndërmarrje e energjisë e licencuar nga Rregullatori për të kryer veprimtarinë e operimit të tregut;



- 1.14. **Tarifat e OST/OT** - tarifat që aplikohen nga OST/OT-ja për ofrimin e shërbimeve nga OST dhe OT.
 - 1.15. **Tarifat e OSSH**- tarifat që aplikohen nga OSSH-ja për ofrimin e shërbimeve nga OSSH.
 - 1.16. **Jetëgjatësi ekonomike** - jetëgjatësia e përdorur për llogaritjen e zhvlerësimit të lejuar në Bazën e asetëve të rregulluara;
 - 1.17. **Faktor ndarës i eksportit** - përqindja fikse që aplikohet në të hyrat e eksportit për të përcaktuar ndarjen e këtyre të hyrave në mes të FMF-së dhe konsumatorëve të rregulluar. Faktori ndarës i eksportit duhet të jetë i mjaftueshëm për të inkurajuar FMF-në që të maksimizojë të hyrat e eksportit, por të mos rezultojë në përfitime të tepruara për FMF-në
 - 1.18. **“EURIBOR”** - norma e ofrimit për depozita të euros nga Federata bankare evropiane për periudhë gjashtë (6) mujore, që paraqitet në faqen e caktuar të shërbimit të “Reuters” në ora 11:00 (kohë e matur sipas kohës qendrore evropiane);
 - 1.19. **Parametra hyrës** - e ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 5;
 - 1.20. **Shqyrtim i parametrave hyrës** - shqyrtimi nga rregullatori për të përcaktuar vlerat hyrëse;
 - 1.21. **Taksë për licencë** - shuma për pagesë sipas Rregullës për Taksat, e nxjerrë nga Rregullatori, e cila mund të amendamentohet kohë pas kohe;
 - 1.22. **Kosto e bartshme** - kostot e përcaktuara në pajtim me Nenin 3;
 - 1.23. **Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejshëm: Rregullatori)** – është agjenci e pavarur në sektorin e energjisë, e themeluar me ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
 - 1.24. **Vit relevant** - periudha prej dymbëdhjetë (12) muajsh të njëpasnjëshëm në mes të përshtatjeve vjetore;
 - 1.25. **Marzhë me pakicë** e ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 5 paragrafi 3;
2. Termat e tjera të kësaj rregulle do ta kenë kuptimin që u është dhënë në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Ligji nr. 05/L-084), Ligjin për Energjinë Elektrike (Ligji nr. 05/L - 085), Ligjin për Energjinë (Ligji nr. 05/L-081) dhe legjislacionin tjetër në fuqi që rregullon sektorin e energjisë.



KREU II KOMPONENTET E KOSTOVE

Neni 4 Përbërja e kostove

- 1 Kostot e ofrimit të shërbimit të Furnizimit të Mundësisë së Fundit përfshijnë kostot fikse me pakicë të furnizimit si dhe kostot që ndërlidhen me vëllimin e energjisë së furnizuar.
- 2 Kostot direkte të furnizimit me pakicë përfshijnë:
 - 2.1. Kostot operative dhe të mirëmbajtjes;
 - 2.2. Kostot e zhvlerësimit; dhe
 - 2.3. Çdo kosto tjetër me të cilën në mënyrë të arsyeshme është ballafaquar FMF-ja gjatë ofrimit të shërbimeve.
- 3 Kostot që ndërlidhen me vëllimin e energjisë së furnizuar përfshijnë:
 - 3.1. Kostot e blerjes së energjisë me shumicë, duke përfshirë kostot e energjisë dhe kostot e kapacitetit; dhe,
 - 3.2. Kostot e bartshme.

Neni 5 Kostot direkte të furnizimit me pakicë

Përveç nëse janë caktuar përmes një procesi konkurrues, kostot direkte të furnizimit me pakicë do të caktohen nga Rregullatori për një periudhë kohore prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.

Neni 6 Kostot që ndërlidhen me vëllimin e energjisë së furnizuar

- 1 Kostot e blerjes së energjisë përfshijnë kostot për kapacitet dhe kostot për energji.
- 2 Kostot për energji përfshijnë kostot e blerjes së energjisë në treg, përfshirë gjenerimin vendor, importin, eksportin dhe kostot e jobalancit.
- 3 Kostoja e eksportit i njihet FMF-së vetëm në rast se ka dallim ndërmjet planifikimit dhe realizimit të konsumit.
- 4 Faktori ndarës i eksportit do të vendoset nga Rregullatori gjatë përcaktimit të parametrave hyrës. Qëllimi i tij është që të ofrojë nxitje për FMF-në, në parashikim sa më të saktë të konsumit.



- 5 Kostot e jobalancit përfshijnë kostot (siç përcaktohen në pajtueshmëri me rregullat e tregut) që rezultojnë nga jobalancet në mes të kërkesës së realizuar nga konsumatorët dhe furnizimit të kontraktuar me energji.
- 6 Faktori ndarës i jobalancit duhet të jetë një përqindje fikse që aplikohet në kostot neto të jobalancit për të përcaktuar ndarjen e këtyre shpenzimeve në mes të FMF-së dhe Konsumatorëve.
- 7 Furnizuesi i Mundësisë së Fundit obligohet që energjinë për furnizim të konsumatorëve ta prokurorë përmes një procesi konkurrues ose t'i demonstrojë Rregullatorit se energjia e blerë pa proces konkurrues ka çmim më të ulët ose të barabartë me çmimin mbizotërues në treg.
- 8 Kosmos së parashikuar të blerjes së energjisë i shtohet Premia e Furnizimit për ofrim të shërbimit të furnizimit të mundësisë së fundit. Premia caktohet gjatë përcaktimit të vlerave hyrëse dhe ka për qëllim të inkurajojë konsumatorët të zgjedhin furnizuesin e tyre të rregullt.
- 9 Kostoja e blerjes së energjisë elektrike do të verifikohet nga Rregullatori, për të parë arsyeshmërinë dhe transparencën e procesit të blerjes.

Neni 7 **Kostot e bartshme**

- 1 Kostot e bartshme të FMF-së janë:
 - 1.1. Kostot për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit OST/OT;
 - 1.2. Kostot për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes; dhe
 - 1.3. Kosto për licencë (nëse është e aplikueshme).
- 2 Kostot për shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes bazohen në Tarifatat e aprovuara nga Rregullatori.

Propozim:

Shfrytëzimi i Sistemit të Transmetimit dhe Sistemit të Shpërndarjes do të bëhet në pajtim me Metodologjitë e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Rrjetit të Sistemit Të Transmisionit (TNUOS) dhe Metodologjinë për Përcaktimit të Ngarkesave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes, të miratuara nga ZRRE.



KREU III PARAMETRAT HYRËS PËR LLOGARITJEN E KOSTOVE

Neni 8 Parametrat hyrës

- 1 Parametrat hyrës të cilët përdoren për llogaritjen e të Hyrave të FMF-së janë:
 - 1.1. Jetëgjatësia ekonomike e asetëve, nëse aplikohet;
 - 1.2. Marzha me pakicë;
 - 1.3. Premiumi i Furnizimit;
 - 1.4. Niveli i përcaktuar për borxhet e këqija;
 - 1.5. Faktori ndarës i eksportit;
 - 1.6. Faktori ndarës i jobalancit; dhe
 - 1.7. Çfarëdo parametri tjetër të cilin Rregullatori e konsideron të arsyeshëm.
- 2 Jetëgjatësia ekonomike e asetëve do të vlerësohet për të reflektuar jetëgjatësinë teknike të asetëve, përveç në rastet kur ekziston arsyeshmëri në lidhje me atë se jetëgjatësia teknike e një asemi duhet të ndryshoj nga jetëgjatësia ekonomike e asemi.
- 3 Marzha me pakicë do të jetë një përqindje fikse që aplikohet në kostot e përgjithshme të FMF-së.
- 4 Marzha me pakicë do të caktohet në atë nivel që t'i sigurojë FMF-së përfitim të arsyeshëm që ta kompensojë për rreziqet që ndërmerr dhe kapitalin punues gjatë ofrimit të shërbimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.
- 5 Marzha me pakicë do të llogaritet duke iu referuar marzhave të fituara nga kompanitë e ngjashme në vende të tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë në mes të industrisë së energjisë elektrike në ato vende dhe atë të Kosovës.

Neni 9 Kostot e lejuara të borxhit të keq

- 1 Niveli i lejuar i borxhit të keq do të jetë një vlerësim i përafërt i nivelit të arsyeshëm të borxheve të këqija që mund ta kenë kompanitë e ngjashme në vende të tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë në mes të industrisë së energjisë elektrike në ato vende dhe atë të Kosovës dhe i cili nuk duhet të kalojë 3%. Kurdo që niveli i realizuar i borxhit të keq është më i ulët se 3%, Rregullatori do ta përshtat kostot dhe nivelin e borxhit të keq në vitin vijues.
- 2 Njohja e borxhit të keq do të konsiderohet si e qëndrueshme vetëm pasi FMF ka dëshmuar se borxhi i tillë është kërkuar të arkëtohet përmes organeve kompetente (gjykatave kompetente ose përmbauesve).



KREU IV LLOGARITJA E TË HYRAVE

Neni 10

Llogaritja e Të Hyrave të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

- 1 Ky nen ka për qëllim të plotësojë implementimin e parimeve themelore të kësaj Rregulle, të shprehura më lart.
- 2 Të Hyrat e FMF-së do të llogariten me anë të kësaj formule:

$$AR_t = RETR_t + (WHPC_t + PSTC_t - NTFR_t + ADJ_t) / (1 - BDTA_t) * (1 + RETM_t + PREM_t)$$

Ku janë:

AR_t	<i>Të Hyrat për Vitin Relevant t</i>
$RETR_t$	<i>Kostot fikse me pakicë në Vitin Relevant t</i>
$WHPC_t$	<i>Kostot e blerjes së energjisë me shumicë gjatë Vitit Relevant t</i>
$PSTC_t$	<i>Kostot e bartshme gjatë Vitit Relevant t</i>
$NTFR_t$	<i>Të hyrat jotarifore në vitin relevant t</i>
ADJ_t	<i>Faktori i Përshtatjes gjatë Vitit Relevant t</i>
$BDTA_t$	<i>Kostot e lejuara për Borxhin e Keq gjatë Vitit Relevant t që caktohet si vlerë përqindjeje (%)</i>
$RETM_t$	<i>Marzha me pakicë në vitin relevant t</i>
$PREM_t$	<i>Premiumi i energjisë në vitin relevant t</i>

Ku $WHPC_t$ llogaritet sipas formulës në vijim:

$$WHPC_t = PPC_t - EXPC_t * EXPF_t + IMBC_t * IMBF_t$$

PPC_t	<i>Kostoja e energjisë elektrike për ofrimin e Furnizimit të Mundësisë së Fundit e prokuruar në treg sipas parimeve të kësaj Rregulle</i>
$EXPC_t$	<i>Të hyrat e lejuara nga eksporti i energjisë në Vitin Relevant t</i>
$EXPF_t$	<i>Faktori ndarës i eksportit në vitin relevant t</i>
$IMBC_t$	<i>Koston neto të jobalancit në Vitin Relevant t</i>
$IMBF_t$	<i>Faktori ndarës i jobalancit në vitin relevant t</i>



KREU V
PËRSHTATJA E TË HYRAVE

Neni 11
Përshtatjet vjetore

- 1 Përshtatjet vjetore do të bëhen para çdo viti relevant.
- 2 Përshtatjet vjetore do të reflektojnë nën-mbulimin apo mbi-mbulimin në mes të faturimit të realizuar dhe kostove të realizuara në një Vit Relevant.
- 3 Të Hyrat e realizuara nga aplikimi i premiumit të Energjisë zbriten nga të Hyrat e Lejuara pas çdo Viti Relevant dhe kontribuojnë në zbritjen e Kostove Fikse me Pakicë të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.
- 4 Përshtatja e të hyrave për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit, llogaritet sipas formulave në vijim:

$$ADJ_t = (ACC_{t-1} - ARR_{t-1}) * (1 + I_v/2) + UNC_{t-1}$$

$$ACC_{t-1} = RETR_t + (WHPC_{t-1} + PSTC_{t-1} - NTFR_{t-1}) / (1 - BDTA_{t-1}) * (1 + RETM_{t-1})$$

Ku janë:

<i>ADJ_t</i>	<i>Faktori i Përshtatjes gjatë Vitit Relevant t</i>
<i>ACC_{t-1}</i>	<i>Kostot e realizuara</i>
<i>RETR_t</i>	<i>Kostot fikse me pakicë në Vitin Relevant t</i>
<i>WHPC_{t-1}</i>	<i>Kostot e blerjes së energjisë me shumicë të realizuara në Vitin Relevant t-1</i>
<i>PSTC_t</i>	<i>Kostot e bartshme të realizuara gjatë Vitit Relevant t-1</i>
<i>NTFR_{t-1}</i>	<i>Të hyrat jotarifore të realizuara në vitin relevant t</i>
<i>BDTA_{t-1}</i>	<i>Borxhi i Keq i realizuar gjatë vitit t-1</i>
<i>RETM_{t-1}</i>	<i>Marzha me Pakicë e realizuar gjatë vitit t-1</i>
<i>ARR_{t-1}</i>	<i>Të hyrat aktuale të faturuara nga FMF</i>
<i>UNC_{t-1}</i>	<i>Kosto tjera aktuale që janë jashtë kontrollit të MFF</i>
<i>Viti t</i>	<i>Viti Relevant t</i>



KREU VI PARIMET E STRUKTURËS SË ÇMIMEVE

Neni 12

Mbulimi i kostove të Furnizimit të Mundësisë së Fundit

- 1 Çmimet e aplikuara për Furnizimin e Mundësisë së Fundit do të caktohen në atë nivel sa të mbulojnë kostot e lejuara të përcaktuara sipas parimeve të kësaj Rregulle.
- 2 Kostot Fikse me Pakicë do të mbulohen nga aplikimi i Tarifës për Furnizim të Mundësisë së Fundit që aplikohet në nivel të transmetimit për të gjithë energjinë e furnizuar në Republikën e Kosovës në bazë të rrjedhave të energjisë.
- 3 Kostot që varen nga vëllimi i furnizimit do të aplikohen në mënyrë transparente, jo-diskriminuese dhe do të reflektojnë koston reale të furnizimit të konsumatorit në pajtim me parimet e kësaj Rregulle.

Neni 13

Procesi i azhurnimeve vjetore

- 1 FMF do të dorëzojë informatat për kostot aktuale dhe të hyrat aktuale të realizuara gjatë Vitit Relevant së paku pesëdhjetë (50) ditë pune para fillimit të Vitit të ardhshëm Relevant.
- 2 Informatat e dorëzuara nga FMF do të përfshijnë përshtatjet e nevojshme të të Hyrave sipas parimeve të kësaj Rregulle.
- 3 Rregullatori në mënyrë të arsyeshme mund të kërkojë nga FMF që të japë sqarime shtesë për metodën e tij të llogaritjes së të Hyrave. FMF duhet të ofrojë, brenda një periudhe të shpejtë kohore, çdo informatë apo shpjegim të mëtejshëm që kërkohet nga rregullatori
- 4 Rregullatori do të njoftojë FMF-në brenda dhjetë (10) ditëve të punës nëse e pranon apo jo përshtatjen e llogaritjes nga FMF-ja. Nëse Rregullatori nuk pajtohet me konkludimet e FMF-së, Rregullatori duhet të ofrojë llogaritje alternative për nivelin e të Hyrave.



KREU VII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 14
Gjuha Zyrtare

Kjo rregull është nxjerrë në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Neni 15
Ndryshimi

- 1 Rregullatori mban të drejtën që ta ndryshojë ose ta modifikojë çdo dispozitë të kësaj rregulle.
- 2 Procedurat për ndryshim ose modifikim të kësaj rregulle do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

Neni 16
Interpretimi

Në rast paqartësie në lidhje me dispozitat e kësaj rregulle, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Rregulla hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Rregullatorit, dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të Rregullatorit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji:

Krenar Bujupi, U.D Kryesues

Arsim Janova, Anëtar

Besim Sejfiqaj, Anëtar